

Fjala e Paqes

*Ju mos u trembni!
Ju kërkoni Jezusin
prej Nazaretit,
të Kryqëzuarin.
Ai u Ngjall,
nuk është këtu.
(Mk 16,6).*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 2 (121) Viti XVII Shkurt - Mars 2015**

KRISHTI, PASHKA JONË, U NGJALL!



Të dashur vëllezër e motra, arritëm edhe këtë vit në kremtimin e Pashkës së Zotit.

Koha e shenjtë e Kreshmëve na ka thirrur në kthim: ta ndryshojmë mënyrën tonë të menduarit për të marrë mendimin e Krishtit (1 Kor 2,16); ta heqim zemrën prej guri për të marrë zemrën prej mishi, fryt të Shpirtit të ri që Zoti na dhuron (Ez 36, 26).

Papa Françesku, në Mesazhin e tij Kreshmor, na ka sugjeruar një pistë: ta mposhtim indiferencën ndaj të afërmit dhe ndaj Hyjit, indiferencë që përfaqëson një tundim real edhe për ne të krishterët. Kjo pistë na ka dhënë mundësi të bëjmë një verifikim të jetës sonë për të parë nëse edhe ne jemi infektuar prej këtij virusi shkatërrimtar modern.

Të kthehemi do të thotë, pra, të rifitojmë vetëdijen për dashurinë e Hyjit ndaj nesh, për praninë e tij në jetën tonë dhe për mëshirën e tij të vazhdueshme. Prej këtu buron drita dhe forca me të cilat populli i Hyjit mund ta mposhtë indiferencën dhe të gjejë përgjigjet ndaj atyre pyetjeve që historia i bën vazhdimisht. Ndoshta unë jam relativisht mirë dhe rehat, por i harroj ata që, ndoshta edhe shumë afër meje, vuajnë sepse janë vetëm, të sëmurë, nevojtarë.

“Hyji nuk është indiferent ndaj botës, por në Birin e vet të dashur hapet përfundimisht dera mes Hyjit dhe njeriut”, na thoshte Papa në mesazhin e tij. Dhe pastaj përdorte një figurë shumë të bukur e domethënëse duke iu referuar Kishës, që është si dora që e mban të hapur këtë derë nëpërmjet shpalljes së Fjalës, kremtimit të Sakramenteve, dëshmisë së fesë që bëhet efikase në dashuri (krh. Gal 5,6). Mjerisht, kjo dhuratë sublime jo vetëm që nuk pranohet gjithmonë, por, përfundon Papa Françesku, “dora, që është Kisha, nuk duhet të befasohet kurrë nëse nuk pranohet, shtypet e plagoset”.

Gjithnjë në mesazhin e tij, na propozonte tri mënyra për ta zbatuar këtë kthim dhe përtëritje:

1. Nisma e 24 orëve për Zotin, në ditët 13 dhe 14 mars, që edhe ne e kemi kremtuar dhe jetuar në Dioqezën tonë me pjesëmarrje dhe përsëritje të madhe. Për këtë e falënderoj shumë Zotin, sepse pavarësisht prej shumë kufizimeve të pranishme në shoqërinë tonë ndihet një etje e madhe për Hyjin dhe për ndihmën e tij.

2. Papa Françesku na propozonte ta dëftojmë interesin tonë ndaj tjetrit me gjepte dashurie, një shenjë, qoftë edhe e vogël e pjesëmarrjes sonë në njerëzimin e përbashkët.

3. Në radhë të tretë, na kujtonte Papa, vuajtja e

tjetrit përbën një thirrje për kthim, sepse nevoja e vëllait më kujton brishtësinë e jetës sime, varësinë time prej Hyjit dhe prej vëllezërve.

E në botën tonë aktuale sa vuajtje ka. Çdo ditë mass-mediat na paraqesin pamje rrënqethëse, mjafton të mendojmë për të arratisurit që arrijnë në brigjet afër nesh në numra tashmë alarmantë dhe që mjerisht shpesh përfundojnë në tragjedi.

Të dashur vëllezër e motra, ecja kreshmore, na kujton në radhë të parë KRYQIN e Krishtit, altar ku Ai kushtohet dhe ia kushton vetveten Atit për shëlbimin e njeriut. Ai bëhet zemra dhe qendra e jetës sonë të krishterë, për ta dashur e dëshmuar me shenjtërinë e jetës. Edhe ne që e dëshmojmë veten të krishterë duhet ta përqafojmë kryqin tonë për të vdekur e për të jetuar në Krishtin. Duhet të vdesim për nga vetvetja, për nga egoizmi ynë, për nga krenaria, për nga gjithçka që nuk i pëlqen Jezusit, për nga gjithçka që është e botës, brenda dhe jashtë nesh.

Na kujton edhe nevojën për të bërë pendesë, pra nevojën për një kthim të vazhdueshëm dhe për një verifikim të vazhdueshëm me Fjalën e Hyjit. Pendesë do të thotë: ndryshim i tërësishëm, përtëritje e brendshme e zemrës, e të ndierit, e të gjykuarit, e të jetuarit.

Na kujton edhe nevojën për të qëndruar veçanërisht afër Zotit Jezus, për të marrë pjesë në mundimet e tij dhe në vuajtjet e tij.

Në përfundim të ecjes sonë kreshmore po vjen ora e ditës së madhe të Pashkës të Zotit, ditë e shpresës dhe e gëzimit të vërtetë e të thellë, sepse Krishti, Pashka jonë, u ngjall. Ai e ka mposhtur vdekjen e mëkatit dhe na ka dhuruar shëlbimin falë flisë së tij, ne tani jemi krijesa të reja, sepse Jezusi na ka larë, na ka pastruar me gjakun e vet.

Prandaj, le t'i hapemi, vëllezër e motra, mirësisë së tij të madhe, dashurisë së tij të mëshirshme dhe le të ecim me Të që na paraprin dhe na tregon rrugën e drejtë që duhet të përshkojmë. Por të mos i mbajmë shpresën dhe gëzimin në sirtarin tonë, t'i shpallim ato me dëshminë tonë të jetës dhe me veprat tona të mira. Le ta çojmë kudo Lajmin e Mirë se Krishti u ngjall, se Ai me të vërtetë u ngjall. Me këto mendime e ndjenja ju uroj nga zemra Pashkë të shenjtë ju katolikëve, ortodoksëve dhe të gjithë të krishterëve.

Përshumëvjet Pashkët 2015!

Imzot Angelo Massafra - Arqipeshkëv

**PAPA FRANÇESKU
NË POMPEI
DHE NË NAPOLI**

Faqe 2

**DITA KOMBËTARE
E JETËS
SË KUSHTUAR**

Faqe 4-5

**UDHA E KRYQIT
NË TARABOSH**

Faqe 3

**DITA DIOQEZANE
E TË RINJVE**

Faqe 6-7

PAPA FRANÇESKU NË POMPEI DHE NË NAPOLI

Papa Françesku bëri vizitën Baritore në Pompei dhe në Napoli, më 21 mars 2015. U nis me helikopter prej heliportit të Vatikanit. Zbriti në "Area Meeting" të Shenjtërores së Pompeit ku bëri lutjen brenda Shenjtërores. Me helikopter arriti në Napoli dhe zbriti në fushën sportive të komunës së Skampias. Në Sheshi i Plebishitit kremtoi Meshën e shenjtë dhe bëri homelinë në vijim:

Pjesa e Ungjillit që dëgjuam na paraqet një skenë të ambientuar në tempullin e Jerusalemit, në kulmin e festës hebraike të tëbanave, pasi që Jezusi ka shpallur një profeci të madhe duke e zbuluar veten si burim i “ujit të gjallë”, pra, i Shpirtit Shenjt (krh. Gjn 7,37-39). Atëherë njerëzit, shumë të prekur, filluan të diskutonin në lidhje me Të. Edhe sot njerëzit diskutojnë në lidhje me Të. Disa janë entuziastë dhe thonë se «është me të vërtetë Profeti» (rr. 40). Dikush madje pohon: «Ky është Mesia!» (rr. 41).

Por të tjerë kundërshtojnë sepse – thonë – Mesia nuk vjen prej Galilesë, por prej fisit të Davidit, prej Betlehemit; dhe kështu, pa e ditur, pohojnë pikërisht identitetin e Jezusit.

K r e r ë t e priftërinjve kishin dërguar disa roje për ta kapur, siç bëhet në diktatura, por këta kthehen duar bosh dhe thonë: «Askurrë askush s'ka folur si ky njeri!» (rr 45). Ja zëri i së vërtetës, që jehon në ata njerëz të thjeshtë.

Fjala e Zotit, dje ashtu si edhe sot, shkakton gjithmonë

një ndarje: fjala e Hyjit ndan, gjithmonë! Shkakton një ndarje mes atyre që e pranojnë dhe atyre që nuk e pranojnë. Nganjëherë një kundërshti e brendshme ndizet edhe në zemrën tonë; kjo ndodh kur ndiejmë tërheqjen, bukurinë dhe të vërtetën e fjalëve të Jezusit, por në të njëjtën kohë nuk i pranojmë ato sepse na vënë në diskutim, na vënë në vështirësi dhe na kushton tepër t'i mbajmë ato.

Sot kam ardhur në Napoli për të shpallur së bashku me ju: Jezusi është Zot! Por nuk dua ta them vetëm unë: dua ta dëgjoj prej jush, prej të gjithëve, tani, të gjithë së bashku “Jezusi është Zot!”, edhe një herë “Jezusi është Zot!”. Askush nuk flet si Ai! Vetëm ai ka fjalë mëshire që mund t'i shërojnë plagët e zemrës sonë. Vetëm ai i ka fjalët e jetës së pasosur (krh. Gjn 6,68).

Fjala e Krishtit është e fuqishme: nuk ka fuqinë e botës, por atë të Hyjit, që është i fortë në përvujtëri, edhe në dobësi. Fuqia e tij është ajo e dashurisë: kjo është fuqia e fjalës së Hyjit! Një dashuri që nuk njeh kufij, një dashuri që na bën t'i duam të tjerët para vetvetes. Fjala e Jezusit, Ungjilli i shenjtë, na mëson se të lumët e vërtetë janë skamnorët në shpirt, jo të dhunshmit, të butët, vepruesit e paqes dhe të drejtësisë. Kjo është forca që e ndryshon botën! Kjo është fjala që jep forcë dhe është e aftë ta ndryshojë botën. Nuk ka një rrugë tjetër për ta ndryshuar botën.

Fjala e Krishtit dëshiron të arrijë tek të gjithë, në veçanti tek ata që jetojnë në periferitë e ekzistencës, që të gjejnë në Të qendrën e jetës së tyre dhe burimin e shpresës. Dhe ne, që kemi pasur hirin që ta marrim këtë Fjalë Jete – është një hir ta marrësh fjalën e Hyjit! – jemi të thirrur të shkojmë, të dalim prej rrethimeve tona dhe, me zjarrin e zemrës, t'u çojmë të gjithëve mëshirën, ëmbëlsinë, miqësinë e Hyjit: kjo është një punë që u takon të gjithëve, por në mënyrë të veçantë ju meshtarëve. Të çoni mëshirë, të çoni falje, të çoni paqe, të çoni gëzim në Sakramente dhe në dëgjim. Populli i Hyjit gjehtë në ju njerëz të mëshirshëm sikurse Jezusi. Në të njëjtën kohë çdo famulli dhe çdo realitet kishtar të bëhet shenjtërore për atë që kërkon Hyjin dhe shtëpi mikpritëse për të varfrit, të moshuarit dhe ata që janë në nevojë. Të shkojë dhe të mirëpresë: kështu rreh zemra e Nënës Kishë, e të gjithë bijve të saj. Shko, mirëprit! Shko, kërko! Shko, ço dashuri, mëshirë, ëmbëlsi.

Kur zemrat i hapen Ungjillit, bota fillon të ndryshojë dhe njerëzimi

ngjallet! Nëse e pranojmë dhe e jetojmë çdo ditë Fjalën e Jezusit, ngjallemi bashkë me Të.

Kreshmët që jemi duke jetuar bëjnë që në Kishë të jehojë ky mesazh, ndërsa ecim drejt Pashkës: në të gjithë popullin e Hyjit rindizet shpresa për t'u ringjallur së bashku me Krishtin, Shëlbuesin tonë. Që të mos arrijë më kot hiri i kësaj Pashke, për popullin e Hyjit të këtij qyteti! Që hiri i Ngjalljes të pranohet prej secilit prej jush, që Napoli të jetë plot shpresë në Krishtin Zot! Shpresa: “Hapjuni shpresës”, thotë motoja e Vizitës sime. Po jua them të gjithëve, në mënyrë të veçantë të rinjve: hapjuni fuqisë së Jezusit të Ngjallur dhe do të sillni fryte jete të re në këtë qytet: fryte të bashkëndarjes, të pajtimit, të shërbimit, të vëllazërisë. Lejoni të mbështillen, të përqafoheni prej mëshirës së tij, prej mëshirës së Jezusit, prej asaj mëshire që vetëm Jezusi na sjell.



Me relikën (gjakun) e Shën Xhenarit

T ë d a s h u r napolitanë, hapjuni shpresës dhe mos lejoni t'jua vjedhin shpresën! Mos bini pre e miklimeve të fitimeve të lehta apo të fitimeve të pandershme: kjo është bukë për sot dhe uri për nesër. Nuk mund të sjellë asgjë! R e a g o n i m e vendosmëri ndaj organizimeve që shfrytëzojnë dhe prishin të rinjtë, të varfrit dhe të dobët, me tregtinë cinike të drogës dhe të krimeve të tjera. Mos lejoni t'jua vjedhin shpresën! Mos lejoni që rinia juaj të shfrytëzohet prej

këtyre njerëzve! Korrupsioni dhe kriminaliteti mos e shëmtofshtin fytyrën e këtij qyteti të bukur! Edhe më shumë: mos e shëmtofshtin gëzimin e zemrës suaj napolitane! Kriminelëve dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të tyre sot unë, përvujtërisht, si vëlla, u përsëris: kthehuni nga dashuria dhe nga drejtësia! Lejoni që t'ju takojë mëshira e Hyjit! Jeni të vetëdijshëm se Jezusi është duke ju kërkuar që t'ju përqafojë, që t'ju puthë, që t'ju dojë më shumë. Me hirin e Hyjit, që fal gjithçka dhe fal gjithmonë, është e mundur të ktheheni në një jetë të ndershme. Jua kërkojnë këtë edhe lotët e nënave të Napolit, të përziera me ato të Marisë, Nënës qiellore të lutur në Piedigrota dhe në shumë kisha të Napolit. Këta lot e shkrifshin ngurtësinë e zemrave dhe i kthefshin të gjithë në rrugën e të mirës.

Sot fillon pranvera dhe pranvera sjell shpresë: kohë shprese. Dhe e sotmja e Napolit është kohë e lirimit për Napolin: ky është urimi im dhe lutja ime për një qytet që ka në vetvete shumë potencialitete shpirtërore, kulturore e njerëzore, dhe sidomos shumë aftësi për të dashur. Autoritetet, institucionet, realitetet e ndryshme shoqërore dhe qytetarët, të gjithë së bashku dhe në harmoni, mund të ndërtojnë një të ardhme më të mirë. Dhe e ardhmja e Napolit nuk është të mbyllet në vetvete duke u dorëzuar: kjo nuk është e ardhmja juaj! Por e ardhmja e Napolit është t'i hapet me besim botës, t'i hapet shpresës.

Ky qytet mund të gjejë në mëshirën e Jezusit, që i bën të reja të gjitha gjërat, forcën për të ecur përpara me shpresë, forcën për shumë ekzistenca, shumë familje dhe bashkësi. Të shpresosh do të thotë t'i bësh ballë të keqes. Të shpresosh do të thotë ta shikosh botën me sytë dhe me zemrën e Hyjit. Të shpresosh do të thotë të mbështetesh në mëshirën e Hyjit që është Atë dhe fal gjithmonë e fal gjithçka.

Hyji, burimi i gëzimit tonë dhe arsyeja e shpresës sonë, jeton në qytetet tona. Hyji jeton në Napoli! Hiri i tij dhe bekimi i tij e ndihmoftshin ecjen tuaj në fe, në dashuri dhe në shpresë, qëllimet tuaja të mira dhe planet tuaja për lirim moral e shoqëror. Të gjithë së bashku e kemi shpallur Jezusin si Zot: le ta themi këtë edhe në fund: “Jezusi është Zot!”, të gjithë tri herë: “Jezusi është Zot!”.

“Zoja e Bekuar ju shoqëroftë”.

DITA BOTËRORE E TË SËMURËVE

“KOHA E KALUAR PRANË TË SËMURIT ËSHTË KOHË E SHENJTË”

Çdo vit më 11 shkurt, për t'iu bashkuar mesazhit të Atit të shenjtë Papa Françeskut, Sektori i Shëndetësisë i Karitasit Dioqezan Shkodër-Pult në bashkëpunim me Arqipeshkvinë, Famullinë Shën Shtjefni, Projektin Shpresa, Motrat e Nënë Terezës, Komisionin Drejtësi dhe Paqe, Madonnina del Grappa, Grupin Ravasko dhe Qendrën Ditore Shtetërore të Zhvillimit, organizon “Ditën Botërore të të sëmurëve dhe të punonjësve të shëndetësisë”.

Mesha e shenjtë u mbajt nga Shkëlqesia e tij Imzot Angelo Massafra. Në meshë morën pjesë qindra besimtarë, të sëmurë, të rinj e të reja me aftësi ndryshe, të cilët ishin sjellë në Katedrale nga familjarët e tyre, por edhe me ndihmën e Motrave të Nënë Terezës, të Motrave Vinçenciane, Motrave Stigmatine dhe kujdestarëve të tyre.

Imzot Massafra lexoi disa fjali nga mesazhi i Papa Françeskut: Koha e kaluar pranë të sëmuri është kohë e shenjtë... Sa të krishterë edhe sot dëshmojnë, jo me fjalët e tyre, por me jetën dhe veprat e tyre, se janë “sy për të verbërin” dhe “këmbë për të çalët”...! Persona të cilët i qëndrojnë pranë të sëmurëve që kanë nevojë për një shërbim të vazhdueshëm, për t'iu ushqyer, pastruar, veshur... Dhe kur ata ndoshta nuk janë në gjendje as të të falënderojnë... Kjo është një ecje e madhe shenjtërimi! ...dhe në ato momente duhet të mendojmë afërsinë me Zotin, dhe, shërbimin duhet ta konsiderojmë si një mbështetje ndaj Misionit të Kishës. Imzot Massafra e përfundoi Meshën e shenjtë duke u lutur për të gjithë të sëmurët e pranishëm dhe sidomos për ata të cilët për arsye shëndetësore nuk kanë mundur të jenë të pranishëm në Meshë.

Pas Meshës të pranishmit morën pjesë në një program artistik ku protagonistë ishin kryesisht fëmijët dhe të rinjtë e Projektit Shpresa, të Motrave të Nënë Terezës, të Qendrës Ditore Shtetërore të Zhvillimit dhe vullnetarë të Karitasit. Dr. Amela Bushati, Drejtore e Shëndetit Publik

falënderoi Kishën Katolike që, përmes strukturave të saj, jep një kontribut të madh në zvogëlimin e problemeve shëndetësore e sociale të popullsisë, gjithashtu falënderoi punonjësit e këtyre institucioneve për punën e përkushtuar që bëjnë, pasi rezultati është konkret. Imzot Massafra falënderoi të gjithë personat që u shërbejnë të sëmurëve dhe të varfërve, pasi gjëja më e mirë që mund të bëjmë në këtë jetë është TË JEMI SAMË TË DOBISHËM PËR TË TJERËT.

Në fakt në dioqezën tonë ofrohen shërbime të ndryshme shëndetësore si në Shkodër, Juban, Bajzë, Prekal, Rragam, Stare, Kir, Trush, Kelmend etj. ku shërbejnë: Motrat Françeskane të Jezusit Fëmijë, Motrat Vinçenciane, Motrat Skalabriniane, Motrat Salvatoriane, Motrat

Françeskane të Krishtit Mbret, Motrat Françeskane Misionare të Suzës, Motrat Stigmatine, Motrat Punëtoret e Vogla të Zemrave të Shenjta, Madonnina del Grappa etj. Përgjegjëse e sektorit shëndetësor është Motër Enza Ferrara.

Në periudha të ndryshme të vitit mjekë të huaj janë të pranishëm për të dhënë kontributin e tyre falas në ambulancat e dioqezës sonë. Vetëm gjatë muajit gusht 850 pacientë të moshave të ndryshme kanë përfutur shërbime dentare falas nga Kalabro dental, e cila ishte e pranishme në Fshatin e Paqes me një grup prej 55 mjekësh italianë me gjithë pajisjet e nevojshme për t'i kryer këto shërbime. Gjithashtu shumë të sëmurë, kryesisht fëmijë janë mjekuar falas në institucionet e shëndetësisë italiane, të cilat për vite me radhë kanë asistuar pacientë pa shpresë shërimi në Shqipëri duke u siguruar mjekimin dhe qëndrimin falas në Itali. E gjithë kjo bamirësi është kryer dhe vazhdon të kryhet në shenjë miqësie dhe solidariteti mes dy popujve: Shqipërisë dhe Italisë.

Jolanda Marena

UDHA E KRYQIT NË TARABOSH

“Hyji është i dashur dhe i mëshirshëm”. Me këto fjalë Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi i Shkodër-Pult, më 14 mars, filloi Udhën e Kryqit në oborrin e Kishës së Shën Marisë Mandalenë. Tashmë traditë prej 18 vitesh, që vazhdon të jetë gjithmonë e përjetuar me devocion dhe përsëritje, qindra të rinj e besimtarë të të gjitha moshave erdhën nga Shkodra dhe nga famulli të shumta të dioqezës, në ditën e bukur të pranverës, për të përjetuar Udhën e Kryqit në Malin e Taraboshit.

Në mes të një turme të madhe njerëzish, grupet rinore afroheshin me radhë për të marrë mbi supë kryqin e mundimeve, sipas ndalesave të caktuara nga grupi “Mësues ku banon”, nismëtarë besnikë të kësaj tradite disaveqare, të udhëhequr nga famullitari Dom Artur Jaku, i cili, me përkushtim dhe kujdes të përpiktë, përpiqej që organizimi të ndihmonte lutjen e secilit besimtar të pranishëm në këtë ecje kreshmore. Edhe pse rruga ishte e vështirë, njerëzit me devocion ndiqnin në heshtje, duke soditur fjalët që u lexonin, këngët që shoqëronin dhe Ruzaren që lutnin.

Një ecje e ngjijtje, ku secili bashkonte vuajtjet e veta, problemet personale, familjare apo shoqërore me vuajtjet e Krishtit, siç e theksoi



Arqipeshkvi në fillim: “Hyji na ka dashur ne aq shumë, sa të flijonte birin e tij të vetëm derisa ne të gjejmë jetën, gëzimin, forcën dhe faljen, e kur t'i gjejmë të kemi kurajon t'ua falim edhe të tjerëve... Ky është kuptimi i Udhës së Kryqit, kjo është domethënia e ecjes tonë sot...”.

Gjithashtu në përfundim të shtegtimit, duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrjen dhe përjetimin e përsëritshëm tha: “Duke iu ngjitur këtij mali kemi pasur mundësi për të menduar vuajtjen e tmerrshme që ka sprovuar Jezusi në Kryq, për të na shpëtuar ne prej mëkateve tona”.

Në të njëjtën orë gjatë ecjes patjetër që e kemi falënderuar Hyjin për të mirat që na ka dhënë e që na jep çdo ditë”. Të dashur vëllezër e motra: jemi ngjitur duke medituar misterin e vuajtjes dhe të vdekjes, tani ulemi prej këtij mali, të bekuar prej Krishtit të vdekur në kryq, por të Ngjallur, të nxitur nga shpresa dhe dashuria, e njëherazi me besimin se jeta me Zotin është më e lehtë dhe më e bukur, sepse Ai është gjithmonë besnik. Amen.

Motër Dukata Radoja

DITA KOMBËTARE E JETËS SË KUSHTUAR



Kisha katolike po përjeton Vitin e Jetës së Kushtuar, dhuratë e Papa Françeskut. Në Shqipëri hapja zyrtare e kësaj nisme u bë më 13 dhjetor 2014, në Shkodër, ku morën pjesë të gjithë rregulltarët dherregulltarët e Shqipërisë.

Duke përfutur nga prania e të gjithë Eprorëve të Lartë të Evropës në vendin tonë, president i të cilëve është Atë Giovanni Peragine (famullitar në Milot), ardhur në Tiranë më 23 mars për të zhvilluar takimin e tyre të radhës, ishte parashikuar që ditën e premte, më 27 mars, në Shkodër, të zhvillohej një ditë lutjeje me të gjithë të kushtuarit që shërbejnë në vendin tonë.

Ishte një ditë shumë e thellë nga ana shpirtërore, sepse në mendjen dhe në zemrën e të gjithë të kushtuarve ishin martirët tanë, të cilët e derdhën gjakun e tyre për fenë e krishterë.

Kjo ditë filloi te Varrezat katolike, në orën 09.30, vend ku disa prej martirëve tanë ishin pushkatuar në kohën e komunizmit, vend ku u kremtua Mesha e Parë pas diktaturës komuniste.

Imzot Angelo u uroi mirëseardhjen ipeshkvijve, të gjithë meshtarëve dhe motrave të ardhura nga dioqeza të ndryshme të Shqipërisë, si edhe Eprorëve të Lartë të Evropës. Më pas filloi procesioni me portretet e 40 martirëve drejt Motrave Klarise, vendi që komunistët e kishin kthyer në Degë të Brendshme. Gjatë rrugës u lexua një biografi e shkurtër e secilit martir. Në oborrin e kuvendit të Motrave Klarise u kremtua Udhë e Kryqit në gjurmët e martirëve të komunizmit, e më pas Eprorët e Lartë të Evropës patën mundësi të shohin muzeun e të njihen më nga afër me historinë e martirëve.

Pas kësaj të gjithë të pranishmit patën mundësi që, te Seminari Ndërdioqezan dhe te salla Kard. Mikel Koliqi, të shikonin një dokumentar mbi përndjekjen e klerit dhe të Kishës katolike.

Kulmi i kësaj dite qe Eukaristia e shenjtë në Katedralen e Shkodrës, udhëhequr nga bariu i kësaj dioqeze Imzot Angelo Massafra. Kjo Eukaristi mbledhi jo vetëm rregulltarët dhe rregulltarët, por edhe një numër të madh besimtarësh, që e kishin mbushur kishën plot.

Pas Meshës Eprorët e Lartë të Evropës u kthyen në Tiranë ku përfunduan edhe takimin e tyre. Duke u kthyer në vendet dhe në bashkësitë e tyre morën me vete një dhuratë shumë të madhe, atë të njohjes më nga afër të kësaj Kise, që aq shumë ka vuajtur dhe që e ka derdhur gjakun për të mbrojtur fenë e vet.



Në vijim homelia e Imzot Angelo Massafra O.F.M.:

“Qoftë lëvdur Jezu Krishti.

Mirë se keni ardhur të gjithë dhe ju falënderoj që keni ardhur në Shkodër, ku jeni duke përjetuar e duke prekur me dorë vendet e vuajtjes e të martirizimit dhe jemi duke kremtuar në katedralen që qe shndërruar prej diktatorit në Pallat Sporti dhe ku më 25 prill 1993 Shën Gjon Pali II ka kremtuar Meshën e shenjtë duke shuguruar katër ipeshkvijtë e parë e duke ringritur në këmbë Hierarkinë e Kishës sonë “Martire”.

“Po blasfemon!”.

Është akuza që judenjtë i drejtojnë Jezusit. E kemi dëgjuar në Ungjill: «Nuk duam të të vrasim me gurë për shkak të ndonjë veprë të mirë, por për shkak të blasfemisë: pse ti, duke qenë njeri, e bën veten Hyj!».

Efektivisht, rojtarët e Besëlidhjes kryejnë detyrën e tyre: të zbatojnë Ligjin dhe të shkulin çdo rrënjë të së keqes. E ku ka të keqe më të madhe se sa pretendimi nga ana e një njeriu se është i barabartë me Hyjin! Në fund të fundit, a nuk qe kjo arsyeja e dëbimit të prindërve të parë prej parajsës tokësore?

Jezusi sapo kishte thënë: “Unë dhe Ati jemi një”. Më qartë se kaq? Kjo, të dashur vëllezër e motra, është blasfemia më e madhe që mund të ekzistojë. Por ajo që është blasfemi për të gjitha besimet e botës, për ne të krishterët është e vërteta që shëllbon botën. Dhe Jezusi përpiqet t'ua shpjegojë kundërshtarëve të vet: madje duke cituar Shkrimet dhe duke i bërë të shohin se “ata, të cilëve u qe drejtuar fjala e Hyjit” janë bij të Hyjit. Aq më tepër Ai që është i dërguari i Atit, madje vetë Fjala e Atit.

Sa mundim i madh ai i Jezusit: t'i bindë anëtarët e një besimi mijëravjeçar se janë gabuar, se duke u përqendruar në Ligjin, duke dhënë shpjegime e duke formuluar rregulla për zbatimin e tij të saktë, kanë harruar se më i rëndësishëm se Ligji është vetë Hyji i cili e ka



shpallur atë. Jezusi na zbulon në këtë pjesë të Ungjillit një rrezik të madh për njerëzit e fesë: që të mos e konsiderojnë më veten në shëmbëlltyrë dhe përngjasim të Hyjit dhe të fillojnë të bëjnë një hyjni në shëmbëlltyrë e përngjasim të vetes. Këtu gjendet përmbysja e vetë konceptit të mëkatit! Mëkati nuk është edhe aq të bëhemi si Hyji (në fund të fundit hyjnizimi i njeriut është një prej boshteve të fesë), sesa ta bëjmë Hyjin të bëhet si ne: i ashpër, despot, i aftë vetëm për të luajtur me fatin e njerëzve, nganjëherë edhe mizor. Jezusi ka ardhur për ta liruar njerëzimin pikërisht prej këtyre ideve të gabuara në lidhje me Hyjin dhe për të zbuluar fytyrën e vërtetë të Atit dhe dashurinë e tij për njerëzimin.

Dhe prova e kësaj dashurie është Biri. Të mohosh se Jezusi është Biri i Hyjit do të thotë të mohosh dashurinë e Hyjit për njerëzimin, do të thotë të biesh në humnerën e asgjësë, gjë e tmerrshme që ndodhte ende në kohët e Jezusit: të mos harrojmë se mes judenjve praktikantë, një pjesë e klasës priftërore, ata që i përkisnin sektit të saducenjve, nuk besonin në ngjalljen prej të vdekurve.

Vëllezër e motra, fjala e sotme e Jezusit na mëson se nuk mjafton të jemi persona fetarë; është e nevojshme ta pranojmë Hyjin në të vërtetën e tij, atë që Jezusi na ka zbuluar dhe t'i lejojmë atij të na lirojë prej ideve të rreme që vazhdimisht jemi të tunduar të ndërtojmë në lidhje me Hyjin dhe me njeriun.

“Po blasfemon!”.

Është edhe refreni që, me fjalë të ndryshme por me të njëjtën domethënie, e ka shoqëruar dhe ende edhe sot e shoqëron martirizimin e Kishës. Shpallja e fesë në Jezusin, e dashurisë së Atit për njerëzimin, është arsyeja e dënimit që duket mbi kryqat e përhapur në kohë e në

Vijon në fq. 5

DITA KOMBËTARE E JETËS SË KUSHTUAR

Vijim i fq. 4



hapësirë, qe nga Jezusi e deri në ditët tona. Bota e urren Jezusin dhe nxënësit e tij, sepse besojma e tyre shemb çdo pretendim për sundim të njeriut mbi njeriun dhe i kthen Hyjit vendin që i takon.

Është e pashmangshme, për atë që shpall autonominë e plotë të njeriut prej Hyjit, që të imponojë zhdukjen e vetë konceptit të Hyjit prej ndërgjegjeve; deri në atë pikë sa të zhdukë, në emër të së njëjtës liri, edhe ata që nuk përputhen me parimet e këtij “spastrimi”. Është ajo që i ka ndodhur Kishës sonë që është në Shqipëri, në kontekstin e totalitarizmit më të ashpër: një vuajtje plagët e së cilës shihen ende dhe itinerari i shërimit të së cilës është ende i gjatë dhe i vështirë.

Martirët tanë janë eksponentët e shkëlqyer të kësaj masakre fetare e kulturore dhe procesi i lumturimit të tyre, që e kemi dëshiruar dhe dashur me forcë, përbën për ne një arsye për të përkujtuar dhe për të bërë thirrje për një të ardhme lirie të vërtetë.

Dhe siç e kuptojmë mirë, përballë faqeve të historisë të shkruara me gjakun e martirëve të rinj në këto ditë të fundit, vuajtja e atyre besimtarëve të Krishtit gjaku i të cilëve i thërret Hyjit prej tokës dhe, i bashkuar me atë të Krishtit, kërkon për njerëzimin shëlbim e falje.

“Po blasfemon!”.

Është tundimi gjithmonë i fshehur, si mëkati i Kainit (Zan 4,7), te dera e Kishës. Shpirti i botës përpiqet gjithmonë të ndikojë edhe në mënyrën e të menduarit të Kishës, në tërësinë e saj si popull e barinj. Prandaj duhet të kemi Shpirtin e Hyjit, shpirtin e shoshitjes, në mënyrë që praktika kishtarë përballë sfidave të kohës sonë të jetë gjithmonë besnike ndaj Ungjillit dhe ta shmangë tundimin që të mendojë me parametrat e kësaj bote.

Në të vërtetë, bota, të dashur vëllezër e motra, ka kritere gjykimi të realitetit dhe të të afërmit që nuk janë ato të Hyjit: a keni vënë re, për shembull, se edhe përballë një katastrofe natyrore, disa përpiqen gjithmonë të gjejnë me çdo kusht një fajtor? “Gishti paditës dhe fjala e keqe”, prej të cilëve na thotë të ruhemi Isaia profet në kap. 58, është stili i botës që Hyji përpiqet ta ndreqë, sidomos brenda popullit të vet.

Pra, mblidhen gurë të pastër; por jo për të gjuajtur të tjerët, por për të ndërtuar struktura të drejtësisë me çimenton e mëshirës. Ftesa e Papa



Françeskut është nxitëse në lidhje me këtë dhe ne duam ta pranojmë atë për të shmangur rrezikun që në Kishë të bëhen sot gabimet e të kaluarës me rrezikun që ajo të bëhet përndjekëse, në çështjet e mëdha të historisë dhe në ngjarjet e vogla të përditshme, në nivelet e larta institucionale ashtu si edhe në administrimet famullitare.

“Po blasfemon!”.

Është edhe tundimi që shpesh fshihet në bashkësitë rregulltare, vende ku përvoja e vëllazërisë duhet të gurgullojë si përrua i furishëm prej burimit të vet, që është dashuria e Hyjit e përjetuar dhe e bashkëndarë. Dhe falë Hyjit shpesh është kështu. Megjithatë, nuk mund ta mohojmë se pikërisht brenda bashkësive rregulltare vazhdojnë situata e qëndrime që nuk kanë aspak të bëjnë me dashurinë e Hyjit.

Nga ana tjetër bashkësitë janë vendi ku njerëzit e përjetojnë këtë dashuri, ku ata rriten në të, ku piqet gjatë viteve një përgjigje që në fillim ndikohej prej “dashurimit”, por që me kohë kërkon të shndërrohet në “dashuri”. Pikërisht siç ndodh në marrëdhënien e çiftit dhe në pjekurimin e marrëdhënieve familjare.

Për shokët e parë të Françeskut të Asizit tregohet se kur përndiqeshin dhe goditeshin me gurë rrugëve, atëherë ata vëllezër bëheshin mburojë e njëri-tjetrit. Pra, vëllazëria e të kushtuarve nuk është vend për t’u goditur me gurë, por vend ku personat bëhen mburojë e njëri-tjetrit... si nga gurët e përndjekjes fizike, ashtu edhe nga gurët e përndjekjes



morale dhe nga ata gurë, shumë më të rrezikshëm, të përndjekjes shpirtërore të vënë në lëvizje prej mëkatit dhe prej të Keqit.

Mbetet e vërtetë se për ta kryer këtë rrugë në mënyrë të përshtatshme, Fjala e Hyjit dhe Eukaristia duhet të përbëjnë qendrën absolute, referimin e parë dhe të fundit të jetës së të kushtuarit. Jashtë këtyre nuk ka Jetë të Kushtuar Zotit; e nëse nuk ka Jetë të Kushtuar Zotit, këtë e ndien e gjithë Kisha.

Në të vërtetë, pikërisht të kushtuarit, të përfshirë në trupin e Kishës, janë për vetë Kishën thirrje në vlerat e amshuara dhe garantojnë, kështu, atë shoshitje të shëndoshë për ta menduar dhe gjykuar realitetin sipas Ungjillit dhe për t’i dashur vëllezërit e botën e krijuar me zemrën e Hyjit.

Vëllezër e motra, Jezusi është përpjekur t’i bindë kundërshtarët e vet duke u nisur prej mirësisë së veprave të tij: ato vepra dëftonin të vërtetën e pohimeve të tij sepse nuk mund të ketë kundërshti mes asaj që thuhet dhe asaj që bëhet. Jeta e Kushtuar Zotit, dhe bashkë me të i gjithë populli i shenjtë i Hyjit, ka vetëm këtë shans për t’u përpjekur që t’i bindë burrat e gratë e kohës sonë për mirësinë e mësimin të tij: përputhja e veprave me atë që shpall.

Prandaj, në këtë vit hiri, kushtuar prej Papa Françeskut jetës rregulltare, të përpiqemi ta njësojmë jetën tonë si të kushtuar, ta shpëtojmë atë prej copëzimit nëpërmjet leximit të Fjalës dhe pjesëmarrjes në Eukaristi, ta lirojmë atë prej kushtëzimeve të kësaj bote të sugjeruara prej princit të kësaj bote. T’i japim një hov të ri formave të dëshmisë që flasin vetë: vepra të mira që i dëshmojnë qartazi botës se Krishti është Shëlbuesi i vetëm, Biri i Hyjit të bekuar, të cilit i qoftë lavdi në shekuj të shekujve. Amen”.

DITA DIOQEZANE E TË RINJVE

Të rinjtë, brezi i ri me Krishtin



Me datë 28 Mars 2015 u mbajt Dita Dioqezanë e të Rinjve në Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi”, Shkodër, me temë: “Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse do ta shohin Hyjin” (Mt 5,8). Si gjithmonë ky takim mblodhi përkrah njeri-tjetrit mbi njëmijë e pesë qind të rinj nga famulli të ndryshme të dioqezës Shkodër-Pult. Gjithçka ishte e menduar dhe e organizuar për të mirën e të rinjve, një favorizim i madh ishte vendi që na mikprit.

Dita filloi me mikpritjen e grupeve të ndryshme, me shenjën e Kryqit, me një psalm. Të rinjve u dha mirëseardhjen edhe prefekti Maxhid Cungu, kryetari i Bashkisë Lorenc Luka, pastaj vijoi momenti reflektues dhe festiv që ishte përgatitur për kënaqësinë e të rinjve të pranishëm. Përveç argëtimit u transmetuan mesazhe të forta. Ndër ta vlen të përmendet dëshmia e Dom Ernest Troshanit, që me përjetimet e tij ka përlotur edhe Papa Françeskun. Dëshmia edhe e sportistit të ri Antonio Marku ishte një tjetër moment i rëndësishëm ku të rinjtë ungjillëzojnë të rinjtë me jetën dhe me angazhimin e tyre.

Momenti argëtues i përgatitur pati një larmi performancash me valle të interpretuara nga të rinjtë e qytetit tonë, poezi të recituara nga aktorë të teatrit "Migjeni", humor dhe këngë të interpretuara nga këngautori i mirënjohur Alban Skënderaj. Pjesëmarrja e rinisë ishte mjaft e madhe, Pallati i Sportit ishte mbushur plot nga mosha të reja.

Të gjithë të rinjtë janë të bashkuar dhe të udhëhequr nga Bariu i dioqezës Shkodër-Pult, i cili me shumë dashamirësi i përshëndeti ata dhe u drejtoi një mesazh të fortë dhe domethënës për ecjen e tyre si të krishterë, që i përkasin një brezi të ri dhe të lirë.

“Shumë të dashur të rinj,

është gjithmonë gëzim të bashkëndaj me ju momente si ky që jemi duke jetuar sot, moment feste, moment takimi, moment bashkëndarjeje.

Është një moment feste sepse hëna e parë e plotë e pranverës na

lajmëron se diçka e re është duke ndodhur: ka mbaruar dimri, jeta rilulëzon dhe natyra ngjyroset si për festë. Ngjallja e Krishtit që po përgatitemi të jetojmë pas një jave përfaqëson simbolikisht të gjithë këtë. Por edhe ju, të dashur të rinj, që jeni shëmbëlltyrë e pranverës dhe e jetës së re që Krishti ka përruar me ngjalljen e vet prej të vdekurve. Ju jeni pranvera e jetës, e shoqërisë dhe e Kishës. Ju jeni arsyeja e shpresës dhe, siç ka thënë Papa Françesku në Tiranë, shtatorin e kaluar, “ju jeni brezi i ri, brezi i ri i Shqipërisë, e ardhmja e Atdheut”.

Ky i yni është një moment takimi. Nuk është vetëm një fakt fizik: “takimi” është një qëndrim që duhet të bëjë pjesë në zakonet më të mira të të krishterit. Ë krejt e kundërta e “përplasjes”. Do të thotë të shkojmë drejt njëri-tjetrit për ta pranuar, për ta njohur, për ta dashur njëri-tjetrin. Është forma e parë e misionit në të cilin jemi të thirrur: nuk mund të themi se jemi të krishterë nëse nuk jemi misionarë dhe nuk mund të jemi misionarë nëse nuk e fitojmë këtë virtut të takimit, duke filluar prej atyre që kemi afër. Ta takoj tjetrin do të thotë ta shikoj në sy, që janë dritaret e shpirtit të tij; të familjarizohem me cilësitë e tij dhe me të metat e tij; do të thotë ta dëgjoj ndërsa flet për të kuptuar brendësinë e tij; do të thotë t'i lejoj të shprehet ashtu siç është, pa pretenduar që ta ndryshoj; do të thotë ta pranoj zemrën e tij që më hapet mua që edhe unë, pastaj, të bëj të njëjtën gjë me të. Ai që e ka takuar Krishtin (dhe presupozohet se secili prej nesh



këtu të pranishëm sot e ka takuar Krishtin ose është duke u bërë gati ta takojë tani) me siguri është ndier kështu: i shikuar, i njohur, i dëgjuar, i lirë për t'u shprehur, i pranuar dhe i dashur. Atëherë, nëse Krishti na ka takuar kështu, edhe ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë me njëri-tjetrin.

Së fundi, ky i sotmi është një moment bashkëndarjeje. Bashkëndajmë me njëri-tjetrin para së gjithash dashurinë që kemi marrë prej Krishtit: vetëm ai që është ndier i dashur është i aftë të dojë me të vërtetë. Dhe nëse rastësisht dashuria që do të kishit dashur nuk ju ka ardhur prej personash të tjerë, atëherë ta dini se Krishtit mund t'i besoni dhe se dashuria e tij për ju është më e madhe se çfarëdo dashurie njerëzore. Bashkëndajmë burimet tona: askush nuk është pa burime; secili ka gjithmonë diçka për të dhënë, por nëse mendoj t'i mbaj dhantitë e mia vetëm për vete do të jem si një lumë që, herët a vonë, do të vërshojë duke përmytur gjithçka. Ndërsa nëse lumi do të jetë i gatshëm të vadisë fushat, të ushqejë lumenjtë, të ushqejë peshqit dhe të derdhet në det, atëherë do të ketë gjithmonë vend për ujë të ri. Ju, të dashur të rinj, me burimet tuaja jeni shumë të çmueshëm për Kishën: çdo bashkësi e krishterë ka të drejtën t'i shohë të rinjtë e vet të angazhuar në vijë të parë që jeta e bashkësisë së krishterë të jetë aktive, e gjallë, e gëzueshme. Një Kishë rinore është ajo e bërë prej të rinjve... jo vetëm për nga mosha (kam njohur persona të moshuar më të rinj se shumë të rinj), por edhe për energjitë që përdoren në të. Kur shkoj në famullitë e

Vijon në fq. 7



DITA DIOQEZANE E TË RINJVE

Të rinjtë, brezi i ri me Krishtin

Vijim i fq. 7

Arkidioqezës shoh gjithmonë shumë të rinj që marrin pjesë në kremtimet, por pastaj konstatoj se shumë prej tyre shpesh largohen prej kishës, dalin, hyjnë, ndoshta shkojnë për të pirë duhan apo për të biseduar me miqtë e tyre përjashta. Mendoj se mërziten ose nuk ndihen mjaft të përfshirë. Atëherë them: po pse nuk shkoni te meshtarët tuaj dhe nuk bëni propozime për një përfshirje më të madhe? Mos kini frikë t'a ofroni bashkëpunimin tuaj meshtarëve dhe motrave. Dua të vë bast pikërisht në sipërmarrjen tuaj rinore.

Në këtë fjalim timin do të ishte dashur t'ju paraqisja Mesazhin që Ati i shenjtë Françesku ju ka dërguar pikërisht për këtë ditë. Por besoj se të gjithë ju dini të lexoni dhe se Papa flet aq thjesht sa edhe fëmijët e marrin vesh. Atëherë, në vend që t'ju bëj një konferencë, kam parapëlqyer të bashkëndaj me ju disa mendime dhe nxitje të miat, e tani, gjithnjë në logjikën e bashkëndarjes për të cilën po ju flisja pak më parë, do të doja t'ju ftoja ta merrni seriozisht në konsideratë Mesazhin e Atit të shenjtë.

Në këtë Mesazh Papa e shpjegon shumë mirë përmbajtjen e lumturisë së shprehur prej Jezusit: “Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse do ta shohin Hyjin”. Shikoni, shumë të dashur të rinj, Lumturitë janë manifesti programatik i Jezusit: nuk mund të mos i njohim ato! Nëpërmjet Lumturive kuptojmë mesazhin e Jezusit dhe se si mund ta jetojmë atë në thjeshtësinë e jetës sonë. Në mënyrë të veçantë, kjo lumturi e pastërtisë së zemrës nuk duhet lënë pas dore, sepse ajo premtan të na bëjë ta shohim Hyjin. Sigurisht, do ta keni pyetur veten se cili është kuptimi apo qëllimi i jetës sonë. Nuk e di çfarë përgjigjeje i keni dhënë ju vetes, por unë, shumë thjesht, duke u nisur prej fesë sonë, i kam thënë vetes se prej Hyjit vijmë dhe te Hyji kthehemi; pra, qëllimi i jetës sime është ai që të shoh Hyjin.

E dini, kjo lumturi ka shumë zbatime praktike që Papa na shpjegon me thjeshtësi dhe, siç ka thënë duke ardhur në Shqipëri, edhe në këtë Mesazh nuk lë pa propozuar besimin e vet në ju të rinj për realizimin e një bote më të mirë. Aju kujtohet se çfarë na ka thënë në Angelus-in e datës 21 shtator?

Po jua përsëris ato fjalë: “Me forcën e Ungjillit, me shembullin e paraardhësve tuaj dhe shembullin e martirëve tuaj, të dini t'i thoni jo idhujtarisë së parasë – jo idhujtarisë së parasë! – jo lirisë së remë individualiste, jo varësive dhe dhunës; dhe t'i thoni jo kulturës së takimit e të solidaritetit, jo bukurisë së pandashme prej së mirës dhe prej së vërtetës; po jetës së shpenzuar me shpirtmadhësi, por besnike në



gjërat e vogla. Kështu do të ndërtoni një Shqipëri më të mirë dhe një botë më të mirë, në gjurmët e paraardhësve tuaj”.

Edhe unë u bashkohen këtyre fjalëve të Papës dhe shfrytëzoj rastin për t'ju shpallur se këtë vit i bie 25-vjetori i Meshës së parë në varrezat e Rrmajve në Shkodër, që ka caktuar fillimin e rënies së komunizmit, kremtuar nga Dom Simon Jubani, me meshtarë dhe rregulltarë të tjerë dhe shumë shkodranë të guximshëm. Shumë prej jush nuk kishin lindur ende, por nuk jemi duke folur për kohë shumë të largëta dhe, sigurisht, e dini se sa vuajtje kemi pësuar pikërisht

sepse kemi qenë të krishterë katolikë. Atëherë, ju ftoj ta shënoni këtë datë: 4 nëntor 2015. Në kujtim të asaj ngjarjeje do të kemi edhe një herë rastin të përtërijmë para të gjithëve guximin për të qenë të krishterë.

Kështu, thjesht, me këtë ftesë dhe me fjalët e Papës, ju uroj ta jetoni në plotësi këtë ditë kushtuar juve dhe të përgatiteni që ta kremtoni këtë



Pashkë që, siç po ju thosha në fillim, ka shumë analogji me rininë tuaj. Le të jeni gjithmonë shëmbëlltyrë e gjallë e Jezusit të Ngjallur. Duke ju vështtruar ju dhe angazhimin tuaj bujar e të guximshëm të jetës së krishterë, kushdo që ju sheh thoshtë se ka takuar Krishtin.

Çojuani përshëndetjen time, urimin tim më të dashur dhe bekimin tim për këtë festë të Pashkës familjeve tuaja”.

Faënderojmë secilin përgjegjës, secilin të ri që ishte i pranishëm, të gjithë ata që në mënyra të ndryshme e bënë këtë ditë të mrekullueshme.



571- VJETORI I BESËLIDHJES SË LEZHËS



Bashkia e Lezhës, me datë 2 mars 2015, në përkujtim të 571-vjetorit të Kuvendit të Lezhës, njëra prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, ka organizuar veprimtarinë kulturore artistike me temë: “Rron në shekuj Besëlidhja e Lezhës”. Në këtë përvjetor të Kuvendit historik erdhën për të festuar në Lezhë qytetarë, nxënës shkollash, personalitete të politikës, historianë, studiues dhe akademikë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Në pritjen e rezervuar nga kreu i Bashkisë Viktor Tushaj, përfaqësuesja e Shoqërisë Civile Nertila Marku, ndër të tjera bëri të ditur kërkesat e një peticioni të përgatitur dhe të firmosur nga intelektualë, historianë, akademikë dhe shqiptarë të diasporës me kërkesën për ta shpallur 2 Marsin Festë Kombëtare. Po ashtu ky peticion kërkonte shkrimin e emrit në pllakën e vitit 1962 Gjergj Kastrioti dhe rikonceptimin e vendvarrimit të heroit në origjinalin e vitit 1468. Më pas në memorialin që ruan vendvarrimin e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti, bënë homazhe e vendosën kurora me lule drejtues të pushtetit vendor, të arqipeshkvisë Shkodër-Pult dhe të dioqezës së Lezhës.

Në fjalën e tij përshëndetëse kreu i Bashkisë Tushaj ndër të tjera tha edhe se ne jemi krenarë që identifikohemi me Gjergj Kastriotin Skënderbeun, këtë kalorës legjendar, që për 25 vjet mbrojti atdheun e vet dhe u bë mburojë e qytetërimit evropian. Sot duke qenë të bindur se shprehim edhe vullnetin dhe dëshirën e historianëve, të shoqërisë civile, por edhe të të gjithë shqiptarëve, është vendi dhe koha të kërkojmë nga Shteti dhe nga Parlamenti Shqiptar që data 2 Mars të shpallet Ditë Feste Përkujtimore Kombëtare. Me krenarinë që i përkasim këtij qyteti, përfundoi fjalën e tij Tushaj, qyteti i cili 571 vjet më parë pati nderin të mikpriste dhe të shënonte Besëlidhjen e parë të shqiptarëve në histori, të punojmë për ta ruajtur këtë qytet si simbol të bashkimit, të



unitetit, të harmonisë dhe të mirëkuptimit njerëzor.

Vetëm të bashkuar shqiptarët, si çdo komb tjetër në historinë e vjetër dhe moderne të botës, theksoi në fjalën e tij përshëndetëse Prefekti i Lezhës Ndrec Deda, kanë dëshmuar se mund të jenë të fortë, se mund t'i realizojnë aspiratat e tyre.

Në këtë 2 Mars përcollën mesazhet e tyre të paqes, të mirëkuptimit, të tolerancës, të vëllazërimit, të bashkimit dhe të harmonisë mes shqiptarëve edhe Arqipeshkvi i Shkodër-Pultit Imzot Angelo Massafra dhe Imami i xhamisë së Lezhës Agim Terziu.

Në vazhdim përshëndetja e Imzot Massafra: “Ju përshëndes të gjithëve dhe falënderoj Kryetarin e Bashkisë që më ftoi. Përshëndes Ipeshkvin e Lezhës Imzot Ottavio Vitale dhe Myftininë e Lezhës, të gjitha autoritet civile, ju të dashur fëmijë, miq, burra e gra.

Është gjithmonë gëzim për mua që të kthehem në vendin ku kam qenë frat e pastaj ipeshkëv dhe ju falënderoj për respektin që keni ndaj meje. Kjo ditë është një ditë historike dhe fryma që ka pasur heroi ynë Gjergj Kastrioti Skënderbeu me gjithë krerët e fiseve dua që të ngjallet edhe sot mes nesh. Mesazhi i kësaj dite është mesazhi i bashkimit për të luftuar

kundër armiqve, si atëherë kur luftuam ushtritë otomane.

Edhe sot unë lus dhe e bëj këtë thirrje në emër të kësaj dite, me



qëllim që të gjithë, duke vlerësuar atë që jemi, pavarësisht fesë dhe ideve politike, domethënë faktin që jemi bij të Hyjit dhe që kemi një Zot që na do të gjithëve, të angazhohemi më shumë që të jemi më të bashkuar për të ngritur shortet e Lezhës dhe të Shqipërisë sonë.

Edhe tani që jemi në rrugë drejt Evropës duhet të japim kontributin tonë. Në atë kohë këtë kontribut e kemi dhënë duke qenë një pengesë e fortë për të ndaluar që Otomanët të mos shkonin deri përtej Romës e Parisit. Sot në kulturën tonë, me angazhimin dhe guximin tonë, si edhe me vlerat që kemi, ndër të cilat është edhe bashkëjetesa fetare, do të shkojmë përtej Adriatikut, duke hyrë kështu në Evropën politike dhe atë gjeografike me vlerat tona.

Ky është urimi im, që t'i themi jo dhunës, jo analfabetizmit, jo të keqes, jo drogës, por po të Mirës, po bashkimit, po kulturës dhe po angazhimit të përditshëm. Urime e faleminderit për vëmendjen”. Në fund, grupet artistike të Pallatit të Kulturës “Ded Ndue Lazri” dhanë një program artistik me këngë kushtuar Gjergj Kastriotit dhe Besëlidhjes së Lezhës.

Rrok Lelçaj

SHËRBESA E LEKTORATIT



Jeta dhe Thirrja janë dy realitete të mahnitshme, të cilat e gjejnë burimin tek bujaria e Zotit. Të gjithë ne seminaristët, ditën e enjte, datë 12 mars, patëm fatin që të sodisnim këtë bujari, e cila duke u ndërthurur me lirinë njerëzore pasuron edhe më shumë Kishën Nënë. Pranimi i shërbesës së Lektoratit nga seminaristët Gaspër Kolaj dhe Mark Pashkja na bëri të gjithë ne dhe mbarë dioqezën tonë pjesë të këtij realiteti bujarie

Ishte pikërisht Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra, i cili në kapelën e seminarit, në këtë ditë, me ndjenja atërore, pranoi Gasprin dhe Markun në shërbesën e Lektoratit. Me ne, gëzimin e kësaj dite e ndanë edhe meshtarët e dioqezës së Shkodrës, të cilët morën pjesë në Meshën e shenjtë pas tërheqjes shpirtërore dioqezane. Prania e Ipeshkvit dhe e meshtarëve të dioqezës është për ne seminaristët një dëshmi autentike se si duhet ta rrënjosim jetën tonë në Krishtin. Kemi dëshirë të falënderojmë për zemërsisht edhe prindërit e familjarët e dy seminaristëve, të cilët ishin të pranishëm me ne në Meshën e shenjtë. Prania e tyre është dëshmi e qartë për kujdesin dhe mbështetjen që ato kanë për bijtë e tyre në ecjen drejt meshtarisë. Në gëzimin e kësaj dite morën pjesë edhe një numër mjaft i madh besimtarësh të ardhur prej famullive të ndryshme, shenjë kjo e miqësisë që ekziston mes tyre dhe seminarit.

Shërbesa e Lektoratit është e lidhur ngusht me shpalljen e Fjalës. Lektor i ka për detyrë që Fjalën e Hyjit ta lexojë në asambletë liturgjike. Ai mund ta lexojë Shkrimin e shenjtë gjatë Meshës por edhe në momente të ndryshme si për shembull në takimet biblike,

katekizëm, etj. Por para së gjithash kjo Fjalë përpara se të shpallet publikisht duhet që të bëhet ushqim për jetën e tij, duhet të jetë forca e gjithë qenies së tij. Lektor duhet të jetë i gëzuar për faktin se është ai i cili ua përçon Fjalën të tjerëve, është "profet" me anë të të cilit Hyji shërbehet për të rizgjuar fenë e atyre që e dëgjojnë. Ai ka një rol edhe jashtë kontekstit të kultit siç e përmendëm edhe më lart, ku kryen një detyrë të rëndësishme që është ajo e shërbimit katekistik dhe e edukimit në fe, si ndaj të rinjve ashtu edhe ndaj të moshuarve.

Ushtrimi i kësaj shërbesë na e bën mjaft të qartë lidhjen e ngushtë që ekziston mes Fjalës së Hyjit dhe liturgjisë. Nëpërmjet kësaj Fjale të shpallur në asambletë e krishtera, Hyji i flet popullit të vet, e po aty Krishti nëpërmjet kësaj Fjale bëhet realisht i pranishëm.

Urojmë dhe kërkojmë prej Zotit që kështu të jetë edhe për Markun dhe Gasprin, që jeta e tyre të jetë fort e rrënjosur në Fjalën e Zotit. Që forca e kësaj Fjale t'i mbushë zemrat e tyre me plot gëzim dhe shpresë, ku prej dëgjimit të fjalës në përditshmërinë e tyre, Zoti të jetë qendra e jetës së tyre dhe krejt e ardhmja e tyre të marrë formë sipas kësaj Fjale, në mënyrë që në Kishë ta shpallin Fjalën e Zotit me fe dhe guxim për të rizgjuar tek besimtarët dëshirën për ta ndjekur Zotin në jetën e tyre. Zoti i shoqëroftë me hirin e tij dhe i ruajtë prej çdo të keqeje!

Kristjan Marku - Viti I Teologji



KATEKEZAT PËR TË RINJTË

Si çdo vit, edhe këtë vit janë organizuar në dioqezën tonë katekezat për të rinjtë gjatë Kohës së Kreshmëve, si një parapërgatitje për ta pritur Pashkën e Ngjalljes së Jezu Krishtit.

Prania e Papës në Shqipëri dhe ftesa që Ai u ka bërë të rinjve "që ta ndërtojnë jetën e tyre mbi Jezu Krishtin" ka ndikuar shumë te pjesëmarrja në këtë katekeza e të rinjve, të cilët ishin vërtet të shumtë në numër. Të katër katekezat janë mbajtur nga Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra, i cili me temat që u ka propozuar të rinjve: ikona e Trinisë së Shenjtë, ikona e kryqit të Shën Damianit, ikona e Nënës së Zotit dhe ikona e Gjon Pagëzuesit, ka nxitur tek të rinjtë interesin për ta

njohur dhe për ta kuptuar sa më shumë dhe sa më mirë misterin e Zotit, i cili ekziston dhe vepron në jetën e tyre të përditshme.

Ajo që na mbetet të themi mbas këtyre katekezave është shpresa që mesazhi i përcjellë me aq zell të mos jetë diçka kalimtare, por të shërbejë si një rizgjim, që ushqen jetën shpirtërore të të rinjve dhe që u jep atyre dritë për t'u ngjallur së bashku me Jezusin, duke i thënë "jo" lirisë së rreme individualiste, "jo" varësive dhe dhunës dhe duke i thënë "po" bukurisë së pandashme nga e mira e e vërteta, duke u bërë dëshmitarë të Fjalës së Zotit, ftesë kjo bërë të rinjve edhe nga Papa Françesku gjatë vizitës së tij në Shqipëri.

Motër Marjeta Gjoka



AKTIVITETE TË ARQIPESHKVIT JASHTË SHQIPËRISË



Kisha e Shna Ndout - Manduria

Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi ynë ka marrë pjesë gjatë muajve të kaluar në këto aktivitete jashtë Shqipërisë:

Me datat 14-17 shkurt 2015 në Romë ka marrë pjesë në krijimin e Kardinalëve nga ana e Papa Françeskut dhe ka pasur gëzimin të përshëndesë pasdite kardinalë të ndryshëm dhe të rishohë disa mjedise të Vatikanit. Të gjithëve u ka dërguar përshëndetjet dhe urimet e Kishës që është në Shqipëri. Ndërsa më 15 shkurt ka pasur takimin e Presidencës së Konferencave Ipeshkvnore për të programuar dhe për të vendosur disa nisma.

Me datat 5-7 mars 2015 Imzot Massafra ka shkuar në Manduria (Taranto), ku ka kaluar shumë vite të jetës së tij pas shugurimit meshtarak, në kuvendin e Shën Antonit, ku ka udhëhequr bashkëkremtimin me rastin e 60-vjetorit të meshtarisë së dy fretërve françeskanë: Atë Maurilio De Cataldo e Atë GianBattista Mancarella, të cilët kanë qenë profesorë të tij të gjuhës latine, greke dhe franceze. Ka



Ascoli Piceno

qenë një Meshë e shenjtë falënderimi kushtuar Zotit për dhuratën e Jetës rregulltare dhe meshtarake dhe për të mirën e madhe që kanë bërë dy fretërit në jetën e tyre si meshtarë, profesorë në shkolla dhe universitete të ndryshme. Me këtë rast u bënë edhe lutje për dhuratën e thirrjes.

Gjatë ditëve 6-10 mars 2015 ka shkuar në Lavis (Trento) në veri të Italisë, sepse kunata e tij ishte në fill të vdekjes. Më 7 mars, në orën 18.00, ka marrë pjesë në Meshën e Famullisë, ku grupi i të rinjve ka paraqitur kërkesën për t'u pranuar si kandidatë në Sakramentin e Krezmimit. Ka qenë një meshë shumë e gjallëruar dhe e bukur: të rinjtë kanë dorëzuar kërkesën me shkrim dhe pastaj është zhvilluar një dialog mbi fenë mes Imzot Angelo-s dhe atyre. Shumë faleminderit Famullitarit Dom Vittorio për këtë mundësi. Më 8 mars, festën e gruas, Imzot Massafra ka pasur një rast tjetër për të ritakuar shqiptarët që jetojnë në Trento: Zonja Leonora Zefi, përgjegjëse pranë TV Telepace Trento për programet javore në shqip (Terre Nostre – Tokat tona), së bashku me bashkëpunëtorët e vet ka përgatitur një ekspozitë mbi 24 vitet e pranisë së shqiptarëve në Trento. Imzot Massafra ka marrë pjesë në hapjen e ekspozitës.

Gjatë ditëve 14-20 mars 2015 ka qenë disa ditë në Ascoli Piceno

dhe në San Marcano të Shën Jozefit, vendi i tij i lindjes.

Në Ascoli Piceno, me nismën e grupit “Comunione e Liberazione” (Bashkim e Liri), ka marrë pjesë, së bashku me Ipeshkvin, Imzot Giovanni D'Ercole, në kremtimin e një meshe për të krishterët e përndjekur me rastin e 800-vjetorit të kalimit të shën Françeskut të Asizit nga Ascoli. Në fund të Meshës së shenjtë së bashku me lutje të tjera është lexuar edhe lutja-poezi e Atë Patti SI, “Sangue a Scutari” (Gjak në Shkodër), ku përshkruhet pjesa më e madhe e torturave të pësuarra prej “Martirëve” tanë. Në orën 21.00 Imzot Massafra ka dhënë një dëshmi mbi jetën françeskane, përpara shikimit të filmit “Fratello sole e Saorella Luna” (Vëlla dielli dhe motër hëna) të Franco Zeffirelli-t.

Në San Marcano Imzot Massafra ka marrë pjesë në Festën e madhe të Shën Jozefit, Pajtor i vendit. Këtë vit është 150-vjetori që kur Shën Jozefi është caktuar si Pajtor i Shën Marcanos. Pasditen e datës 18 mars ka marrë pjesë në procesionin tradicional për të përgatitur zjarrin e madh: besimtarët sjellin dru, vijon bekimi dhe pastaj dorëzimi i çelësave



Lavis (Trento)

të vendit Shën Jozefit. Me datën 19 mars, e kremtja e Shën Jozefit, Imzot Angelo ka kremtuar Meshën e shenjtë në orën 11.00 në Kuvendin e Shën Françeskut në Savë dhe pas Meshës ka bekuar, përgjatë rrugës, ushqimin e përgatitur prej të devotshmëve për besimtarët dhe të varfrit... një traditë shumë domethënëse solidariteti ndaj të varfërve për të nderuar Shën Jozefin, si Provani. Ndërsa pasdite ka marrë pjesë në procesionin e zhvilluar në San Marcano, një shfaqje e madhe feje. Në fund të procesionit ka udhëhequr Meshën në kishën e kushtuar Shën Karli Borromeo. Ka qenë vërtet bukur për Ipeshkvin të kthehet në vendin e vet të lindjes dhe të takojë familjarë, miq të vjetër dhe shokë të fëmijërisë. Një falënderim të veçantë për Famullitarin, Dom Cosimo Rodia, dhe për të gjithë bashkëfshatarët arbëreshë.



Sava (TA)

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

PROMOVIMI I LIBRIT “THEMELIMET E SHËN TEREZËS”

Me rastin e 500-vjetorit të lindjes së Shën Terezës së Avilës, që këtë vit është shpallur edhe Viti Jubilar i saj, bashkësia e Motrave dhe e Etërve Karmelitanë organizuan, më 22.02.2015, ceremoninë e promovimit të librit “THEMELIMET E SHËN TEREZËS”, botuar për herë të parë në gjuhën shqipe me përkthyes Luket Hasaj. Ceremonia u mbajt në kishën e Shën Mëhillit pranë kuvendit karmelitan, ku morën pjesë Ipeshkvi i vendit Imzot Lucjan Avgustini, meshtarë e motra të Karmelit dhe të kongregatave të tjera që veprojnë në dioqezën e Sapës, si edhe shumë besimtarë. Me urimin e mireseardhjes eprori i Etërve Karmelitanë në Nënshat, Atë Mariano Tarantino përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për praninë e tyre. I ardhur enkas për këtë eveniment ishte Atë Emilio J. Martinez Gonzales, O.C.D., zëvendës i Atit Gjeneral të Urdhrit Karmelitan, i cili mbajti ligjëratën mbi Shën Terezën e Jezusit dhe solli përshtypjet e tij pozitive për librin. Në fillim Atë Emilio zbuloi imazhin e Shën Terezës duke bërë bekimin e saj, ndërsa më pas mbajti ligjëratën duke shpalosur biografinë, jetën dhe veprën e Shën Terezës, që njihet edhe si Doktore e Kishës.

Në parathënien e librit shkruar nga Atë Egidio i Jezusit, thuhet se Tereza e Jezusit, duke i bërë jehonë mësimin të Shën Gregorit të Madh, e përsërit shpesh në shkrimet e saj se veprat janë dëshmia më e mirë e dashurisë. Dhe me këtë nënkupton kryesisht ushtrimin e virtyteve. Por duke e parakuptuar këtë, e quan gjithashtu tejet të lumtur atë që mund të sjellë lavdinë më të madhe të Hyjit edhe me vepra të jashtme. E në lidhje me këtë fjalët e saj përmbajnë një afsh që të ndez flakë, sidomos aty ku ankohet se është grua, meqë si e tillë nuk

mund të predikojë dhe të shpëtojë shpirta. Shën Tereza predikuese! Kush mund ta përfytyrojë këtë grua të mrekullueshme, kaq të fortë, kaq të zjarrtë, kaq të dhembshur, kaq qiellore dhe njerëzore mbi një amvonë të kishave tona apo në mes të grupeve të të pafeve? Është ky përfundimi i këtyre rreshtave.

Edhe Imzot Lucjani në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi librin e Shën Terezës, i cili do t'i vijë në ndihmë çdokujt që e lexon atë. Ai përcolli fjalë lavdëruese për vlerën shpirtërore që mban libri në fjalë, gjithnjë duke iu përmbajtur rregullit të meditimeve.

Ceremonia u pasua me lutjen e pesëqindvjetorit të lindjes së Shën

Terezës, me adhurimin e të shenjtërueshmit sakrament dhe u përmbyll me lutjen e mbrëmësore.

Libri “Themelimet e Shën Terezës së Avilës”, i përkthyer nga origjinali me titull “Las Fundaciones”, vjen për herë të parë në gjuhën shqipe për lexuesin shqiptar. Është një libër narrativo-historik, ku Tereza tregon për themelimet e kuvendeve të Karmelitanëve të Zbathur në Spanjë, në shek. XVI, me gjithë vështirësitë e shumta që has dhe përpjekjet e jashtëzakonshme që duhet të bëjë, si edhe

përvojat e saj shpirtërore dhe huret hyjnore që merr. Flet edhe për udhëtimet e saj të gjata dhe të vështira në krahinat e ndryshme të Spanjës, me entuziazmin që e karakterizon, pa marrë parasysh rrugën, motin dhe shëndetin e saj të dobët.

Tregimi i saj është i thjeshtë dhe i këndshëm. Nga pikëpamja historike ky libër është më tërheqësi i të gjithë krijimtarisë tereziane, sikurse edhe është padyshim më i përkryeri nga ana letrare. Libri përmban 31 kapituj ku secili mbart një histori më vete.

TAKIMI DIOQEZAN I THIRRJEVE DHE I RINISË

Në fundjavën e 14 shkurtit 2015, Dioqeza e Sapës ishte mikpritëse e seminaristëve që studiojnë në Seminarin Ndërdioqezan “Zoja e Këshillit të Mirë” në Shkodër. Duke qenë se kjo vizitë e tyre përkoi edhe me takimin dioqezan të thirrjeve dhe rinisë, ata zhvilluan një takim shpirtëror dhe miqësor si me të rinisë ashtu edhe me besimtarët nëpër famullitë ku u shpërndanë. Ky takim ishte edhe i një rëndësie tjetër: seminaristi Zef Marku, nga famullia e Shën Nikollit Vau-Dejës u pranua zyrtarisht si kandidat për meshtar.

Takimi u zhvillua në Katedralen “Nënë Tereza” në Vau-Dejës dhenisi me lutjen fillestare, pastaj me meditimin mbi Kështjellën e Brendshme të Shën Terezës së Avilës udhëhequr nga meshtari karmelitan Atë Mariano Tarantino. Ai e kishte përshkruar këtë meditim me shumë pyetje që kanë lidhje me jetën tonë të përditshme shpirtërore. Konkretisht kush jemi ne? Ku jemi ne? Kush është Hyji për ne? A jemi ne një kështjellë? E të gjitha këtyre pyetjeve Shën Tereza e Avilës u ka dhënë përgjigje: Unë jam një kështjellë, por jetoj si në një barakë. Dera e kësaj kështjelle është lutja dhe meditimi ndaj duhet të gjejmë mënyrën për të hyrë në të... Jeta jonë, shpirti ynë, përgjigjet Shën Tereza e Avilës, është si një kështjellë e bërë nga një diamant i vetëm ose nga një kristal shumë i pastër, në të cilin ka

shumë banesa... që do të thotë se ka shumë mënyra për ta takuar Zotin. S'ka asgjë që mund të krahasohet me bukurinë e madhe të një shpirti që vetë Zoti me pagëzimin tonë e ka vënë brenda nesh, e që është dhurata e Shpirtit Shenjt. Pas kësaj ligjërate të rinjtë u ndanë në grupe ku reflektuan dhe komentuan këtë meditim, por edhe vetë seminaristët me praninë e tyre sollën një përvojë tjetër të hyrjes në kështjellën e brendshme - atë të një thirrjeje të veçantë.

Takimi kulmoi me kremtimin eukaristik të udhëhequr nga Bariu i kësaj grigje, Imzot Lucjan Avgustini, i cili i ftoi të rinjtë që të ushqehen çdo ditë me Fjalën e Hyjit, prej të cilës ne jetojmë, dhe me gëzim e dashuri të bashkëpunojnë me të. “Jemi të thirrur të gjithë - tha ai - që ta kultivojmë fenë tonë personale”. Duke përfunduar Shkëlqesia e tij tha se secili prej nesh duhet të jetë shëlbues i vogël i botës, sepse Zoti na fton të bashkëpunojmë për realizimin e hishtorisë së shëlbimit.

Ai falënderoi Zotin edhe për thirrjen e të riut Zef Marku në rrugën e meshtarisë dhe përcolli urimet për një ecje me vazhdimësi të mbarë gjatë studimeve drejt finalizimit. Me këtë urim dhe me bekimin e shenjtë përfundoi i gjithë kremtimi i kësaj dite.

Violeta Marashi

FOTOKRONIKË



Në ish-Dega e Brëndshme



Lezhë



San Marzano di San Giuseppe (TA)



Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Loreta Tomaj

Faqosja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë